



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI PËR ÇËSHTJET VENDORE

Nr. 2737 Prot.

Tiranë, më 3.06.2015

URDHËR

Nr. 2737, datë 3.06.2015

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR MINISTRIN E
SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE

Në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 19 të ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI),

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore sipas Lidhjes Nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri;
2. Përditësimin e Programit të Transparencës në përputhje me nenin 4, 5 dhe pikën 2 të nenit 19 të LDI-së me qëllim:
 - a. garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
 - b. vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.
3. Publikimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore www.ceshtjetvendore.gov.al nën një menu të veçantë të emërtuar “Programi i Transparencës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR
BLEDAR ÇUCI
